



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Nr. No. 02-052/01-0023627/20  
Data 01.07.2020



Komuna e Skenderajt  
Opštine Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

### Zyra për informim

Datë	30.06.2020
Nga	Zyra për informim në komunën e Skenderajt - Endrit Nura
Për:	Publikun
Lënda	Raport informues mbi Dëgjimet Publike në gjashtë mujorin e parë të vitit 2020

Komuna e Skenderajt, edhe në vitin 2020 ka vazhduar me konsultime dhe dëgjime publike, kështu duke rritur nivelin e bashkëpunimit me qytetarë.

Edhe përkundër faktit që jemi përballur me pandeminë COVID-19, komuna e Skenderajt nuk ka ndaluar aktivitetet dhe projektet në interes të qytetarëve, duke mirë menaxhuar situatën, me ç' rast janë përkrahur 4,000.00 familje me pako ushqimore dhe higjienike dhe miell, po ashtu në qytet dhe çdo bashkësi lokale, fshatra dhe lagje janë realizuar dhe po realizohen projekte kapitale, por realizimin e tyre dëshirojmë ta bëjmë në konsultim me qytetarin, nevojat dhe kërkesat e qytetarëve, kështu do të vazhdojmë me takime dhe konsultime të njëpasnjëshme. Brenda gjashtë mujorit të parë të vitit 2020, janë mbajtur 1(një) dëgjim publik i kryetarit, dhe 6(gjashtë) dëgjime publike për Kornizën Afat-Mesme Buxhetore.

Në dëgjimin e parë publik, të organizuar konform rekomandimeve të IKSHP-së, kanë marrë pjesë 172 qytetarë, OJQ, shoqëria civile dhe përfaqësues të fshatrave, ku kanë ngritur çështjet e tyre përmes kërkesave dhe rekomandimeve, për infrastrukturë rrugore, rrjet ujësjellësi, rrjet kanalizimi, ndriçim publik, trotuare, poligone dhe fusha sportive, çerdhe dhe shkolla, ambulanca, hapësira gjelbëruese dhe zhvillim ekonomik. Edhe nga Kryetari i komunës, z. Bekim Jashari morën deklarinimin për angazhim të dinjitetshëm dhe qeverisje me duar të pastërta dhe në shërbim të interesit të përgjithshëm, konform mundësive buxhetore.

Në dëgjimet për KAB, të organizuar konform rekomandimeve të IKSHP-së, kanë marrë pjesë 331 qytetarë, OJQ, shoqëria civile dhe përfaqësues të fshatrave, ku kanë ngritur çështjet e tyre përmes kërkesave dhe rekomandimeve, për infrastrukturë rrugore, rrjet ujësjellësi, rrjet kanalizimi, ndriçim publik, trotuare, poligone dhe fusha sportive, çerdhe dhe shkolla, ambulanca, hapësira gjelbëruese dhe zhvillim ekonomik. Edhe nga Kryetari i komunës morën deklarinimin për angazhim të dinjitetshëm dhe qeverisje me duar të pastërta dhe në shërbim të interesit të përgjithshëm, konform mundësive buxhetore.